

KONTRATE PER SHITJEN AKSIONESH

Ne Tirane, sot me date 21.Prill.2015, ne ambjentet e selise se shoqerise "IMPULS-95 sha , Bradashesh Katund i Ri Autostrada Elbasan - Metalurgji,km 3, ne te djathte te autostrades, Komuna Bradashesh, Elbasan, u perpilua kontrata e shitjes se kuotave si ne vijim midis paleve :

SHITESI :

Arjan SHYTI, i biri i Hydriut dhe Myniveres,shtetesi shqiptar,i dtl 1960 lindur ne Kavaje dhe banues ne Tirane, identifikuar sipas leternjoftimit bashkangjitur ,zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise aksionere.

BLERESI :

Bujar MUÇA, i biri i Shanihinit dhe Kadimes qytetar shqiptar,i dtl 1972, lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane, identifikuar sipas leternjoftimit bashkangjitur , zoterues i 50% te kapitalit te shoqerise aksionere.

Te cilet bien dakord si me poshte:

Objekti i kontrates

Asambleja e aksionereve te shoqerise me vendimin e saj date 21/Prill/2015, bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe Statutit te Shoqerise (i ndryshuar), ka vendosur:

- Miratimin e shitjes se aksioneve nga aksioneri Arjan Shyti tek aksioneri Bujar Muça, sipas kushteve te rena dakord prej tyre ne kontraten e shitjes se aksioneve.
- Ne vijim, aksioneri Bujar Muça mbetet aksioner i vetem i shoqerise, duke zoteruar 100 % te aksioneve, me vlere te barabarte me 100 % te kapitalit themeltar.
- Ngarkohet ortakut i vetem Bujar Muça te kryeje formalitetet ligjore te parashikuara nga ligji per publikimin e faktit se shoqeria mbetet me nje aksioner te vetem.

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes se aksioneve, te cilat perfaqesojne 50 % te kapitalit te zoteruar nga aksioneri z.Arjan Shyti, dhe qe transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te aksionerit ekzistues z.Bujar MUÇA, eshte ne vleren 28,150,000 leke.

Bleresi ka paguar sipas paragrafit te mesiper çmimin e shitjes ne llogarine rrjedhese bankare, sipas marrveshjes se paleve, dhe shitesi deklaroi se e ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.

ARJAN SHYTI

Bujar Muça

Garancite

Shitesi deklaroi dhe garanton se eshte i vetmi titullar i ligjshem i aksioneve qe po transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe se ato jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjetër ligjor dhe pergjigjet personalisht per cdo evikcion te mundshem ne te ardhmen.

Heqje dore nga te drejtat dhe detyrimet

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale, se pasketej heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne mbi 50% te kapitalit dhe aksioneve qe ajo perfaqson ne shoqerine "IMPULS - 95 " sha, te drjetaketo qe i kaoljne dhe do te ushtrohen nga Bleresi i ketyre aksioneve, i cili tashme zoteron 100 % te kapitalit ne shoqeri, ne vleren 56,300,000 leke.

Te ndryshme

Cdo detyrim administrativ apo fiskal qe lind nga ky transakcion do te perballohet nga perfituesi (shitesi).

Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate Bleresi aksioneri Bujar Muça mbetet aksioner i vetem i shoqerise, duke zoteruar 100 % te aksioneve, me vlere te barabarte me 100 % te kapitalit themeltar dhe ka detyrimin te kryeje formalitetet ligjore te parashikuara nga ligji per publikimin e faktit se shoqeria mbetet me nje aksioner te vetem.

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe palet deklaruan se jane dakort me sa me sipër, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht.

SHITESI
Arjan SHYTI

ARJAN SHYTI
Ro

BLERESIT
Bujar MUÇA

Bujar Muça
Bujar Muça



ITALIANA PETROLI
Impuls 95 Sh.A.
K42619205W
TIRANA - ALBANIA